



Projekt i financuar nga BE-ja dhe i menaxhuar nga Zyra e Bashkimit European në Kosovë



Raport nga konferenca

“Pikëpamjet e qytetarëve rreth çështjeve kyçe të sigurisë në Kosovë”

23 Tetor 2013, Prishtinë, Hotel Emerald

Hyrje

Më 23 tetor 2013, FIQ dhe AKTIV me mbështetjen e Saferworld, në kuadër të zbatimit të projektit “Fuqizimi i organizatave të shoqërisë civile në Kosovë për t’u bërë kontribues të efektshëm të procesit të hartimit të politikave të sigurisë dhe të vendimmarrjes”, organizuan konferencën me titull **“Pikëpamjet e qytetarëve rreth çështjeve kyçe të sigurisë në Kosovë”**. Kjo konferencë, është pjesë e projektit të mbështetur financiarisht prej Bashkimit Europian të përfaqësuar nga Zyra e Bashkimit Evropian, në kuadër të Instrumentit për Shoqëri Civile për Kosovë.

Gjatë periudhës qershor – korrik 2013, organizatat FIQ dhe AKTIV në bashkëpunim me shtatë OShC vendore kanë organizuar takime dialoguese me qytetarë përkatësisht në Gjilan, Mitrovicë, Shtërpçë, Klinë, Gjakovë dhe Prizren. Në këto takime janë mbledhë së bashku grupe të ndryshme të shoqërisë për të diskutuar rreth çështjeve kryesore që prekin nivelin e paqes dhe të sigurisë në Kosovë, duke ndikuar në këtë mënyrë në jetën e përditshme të njerëzve. Në këto takime dhe gjatë 11 intervistave gjysmë të strukturuar dhe kanë marrë pjesë mbi 135 pjesëmarrës. Këto intervista janë mbajtur nga IDK në kuadër të Forumit për Siguri në Prishtinë dhe nga Forumi për Parandalimin e Konfliktit nga veriu i Mitrovicës. Informatat e mblidhura nga ky proces janë shqyrtuar përmes hulumtimeve nga zyra.

Në konferencën në fjalë, u bë publikimi i hulumtimit të titulluar “Pikëpamjet e qytetarëve për çështjet kryesore të paqes dhe sigurisë në Kosovë”, gjetjet e të cilit hulumtim gjatë konferencës i prezantoi Adem Gashi nga IDK.

Konferencën e hapi znj. Dajana Berisha, Drejtore Ekzekutive në FIQ, ndërkaq fjalime hyrëse mbajtën: z. Melvin Asin, Zv.Drejtor i Departamentit për Bashkëpunim pranë Zyres së BE-së, nën Programin e Kosovës për Shoqëri Civile dhe z. Astrit Istrefi, kryesues për Evropë dhe Azinë Qëndrore në Saferworld.

z. Melvin Asin u shpreh se projekti është shumë konkret dhe përmes tij ne duam që të përballemi me parandalimin dhe me pasojat. “Ne konsiderojmë se angazhimi i shoqërisë civile kredibile është crucial për politikën e sigurisë, për ndikimin që të krijohet sektori i sigurisë i përgjegjshëm dhe llogaridhënës. Nga perspektiva e BE-së, ne duam të shohim këtë pjesëmarrje të qytetarëve dhe shoqërisë civile, prandaj dhe vazhdojmë të mbështesim OSHC-të në këtë proces të dialogut konstruktiv me qeverinë. “ u shpreh z. Asin.

z. Astrit Istrefi, në anën tjetër, u fokusua në dy çështje të rëndësishme: besimi i publikut në polici dhe dialogu apo marrëveshjet nga procesi i lehtësuar nga BE-ja në mes Prishtinës dhe Beogradit. “Në të parin, është e pabesueshme që në dy-tre vitet e fundi ka rënë vazhdimisht besimi i publikut në PK, ndërsa disa vite më parë ishte institucioni më i besueshëm. Duhet të jemi koshient se si t’i interpretojmë këto perceptime. Është përshtypje e qytetarëve që PK të jetë më e shpejtë dhe efikase në veprimet e saja. Ne duhet t’i marrim seriozisht këto perceptime, sepse në këtë hulumtim kanë qenë të përfshira shumë komunitete në takime. Sidoqoftë, ne kemi rol kyç në mbështetjen e Policisë dhe vlerësojmë progresin e bërë gjatë këtyre viteve në reforma dhe në praktikatat e vendosura. Ata janë të hapur ndaj shoqërisë civile dhe publikut dhe të përkshuar.” u shpreh z. Istrefi, ndërkaq sa i përket dialogut, s’ka dyshim se ka patur progres në arritjen e marrëveshjeve, mbylljen e një kapitulli të së kaluarës dhe hapjen e kapitullit të së ardhmes. Shoqëria civile ka rol kyç në këtë proces dhe ata duhet të shihen si asete në mbështetjen e procesit të zbatimit të marrëveshjeve. Ne duhet të sigurohemi që shoqëria civile është pjesë e çfarëdo procesi në Kosovë dhe jo të shikohet si aktor jokontribues.

*Konferenca u nda në dy sesionet, detajet e së cilave i gjeni në faqen vijuese.



Përmbledhje nga konferenca

Si të adresohen në mënyrë efektive përdorimi i drogës, aksidentet në komunikacion dhe brengat e qytetarëve lidhur me punën e policisë?

Ky sesion u moderua nga znj. Dajana Berisha, Drejtore Ekzekutive e FIQ.

Panelistë të këtij sesioni ishin:

Z.Çlirim Hajdini, Policia e Kosovës

Z.Ergin Mediq, Zv.Drejtor i Drejtorisë Rajonale në Mitrovicë-PK, (MUNGOI)

Z.Safet Blakaj, Drejtor i Qendrës Mediko-Psikoterapike “Labyrinth”

Për Policinë e Kosovës, rënja e besimit në këtë institucion është tejet shqetësuese dhe sipas tyre, janë duke e trajtuar me seriozitet. PK, ka strategjitë dhe dokumentet e duhura me të cilat punon dhe poashtu rëndësi i kushtohet bashkëpunimit me OShC. PK, u shpreh se ka Strategjinë Kundër Narkotikëve, por problemi i drogës është shumëdimensional, jo vetëm policor, ndërsa trafikimi i drogës është problem transnacional.



Sa i përket shifrave, në vitin 2004 fillimi i përdorimit të drogës nga të rinjtë përfshinte moshën 21.6 vjeç, ndërsa në 2012 kjo moshë mesatare ra në 16.2 vjeç. Në Kosovë janë 3,000-5,000 përdorues probematik të drogave. Shqetësim paraqet prezenca e të ashtuquajturave droga të reja të dizajnuara. Trajtimi, parandalimi, dhuna në familje, krimet, janë çështje shumë të ndërlikuara.

Problemi më i madh gjatë konferencës u vërejt në moszbatimin e ligjeve dhe strategjive, të cilat i kemi me shumicë.

Si të komunikohet në mënyrë më efektive tek qytetarët marrëveshja mes Prishtinës dhe Beogradit?

Ky sesion u moderua nga znj. Jana Poljakova, Menaxhere e Projektit, AKTIV.

Panelistë të këtij sesioni ishin:

Z.Stojan Pelko, Zyra e BE-së në Kosovë

Z.Rexhep Selimi, Zv/Kryetar i Komisionit Parlamentar për Siguri dhe Punë të Brendshme

Znj.Jeta Xharra, Drejtore e BIRN-it

Z.Zeljko Virijeviq, Forumi për Parandalimin e Konfliktit

Sa i përket dialogut Kosovë-Serbi ka mungesë të plotë të transparencës; mos komunikimi i



dialogut me të gjitha nivelet e shoqërisë, shihet si një strategji për të mbërritë deri në fund të procesit pa qartësuar çfarë marrëveshje po arrihet dhe vetëm mbasi të arrihet një marrëveshje ndërmjet palëve të informohet popullata rreth rezultatit. Gjykimi i përbashkët është se dialogu ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit duhet të ndodhë jo vetëm në mes të

politikanëve, por ai duhet të njihet prej shoqërisë civile, prej popullatës, pasi në fund afekton jetët e të gjithë kategorive në Kosovë.

Z. Stojan Pelko nga zyra e BE-së në Kosovë, prezantoi disa vështrime lidhur me raportin duke shprehë se mungesa e vizionit se ku çon dialogu nuk është e vërtetë, sikurse nuk është e vertetë që publiku është i keqinformuar. Z. Pelko poashtu u shpreh se paradoksi i dialogut është që në fund, rezultati do të përcaktojë fillimin, ndërkaq sa i përket realitetit politik, edhe pse këtë nuk e tha në cilësinë e zyrtarit të BE-së, është se “njerëzit në veri nuk përfaqësohen ende”.

Sipas z. Rexhep Selimit, marrëveshja nuk i është komunikuar as Kuvendit dhe kur kjo transparencë mungon edhe për Kuvendin, atëherë s’ka se si t’i komunikohet publikut.



Konkluzione

- **Moszbatimi i ligjeve dhe strategjive, si dhe mungesa e kohezionit institucional** edhe më tutje vazhdojnë të mbeten problemet kyçe;
- **Siguria në trafik** - nuk ka nisur zbatimimi i mekanizmave ndeshkues si heqja e pikëve, ndërkohë që problem shihet edhe kultura e vozitjes;
- **Besimi në polici** – këtu ka perceptime të ndryshme, por rritja e shifrave të krimit është një nga faktorët që ndikon në rënien e besimit në këtë institucion, i cili vite më përpara ka qëndruar në majat e institucioneve më të besueshme në vend;
- **Drogat** - shqetësuese është rritja e përdoruesve dhe zvogëlimi i moshës së përdoruesve në ndërkohë që sfida mbetet trajtimi, puna parandauese dhe investimi në qasjen shkollë-prindër-nxënës;
- **Dialogu mes Kosovës dhe Serbisë:** ka mungesë të plotë të transparencës; mos komunikimi i dialogut me të gjitha nivelet e shoqërisë, shihet si një strategji për të mbërritë deri në fund të procesit pa qartësuar çfarë marrëveshje po arrihet dhe vetëm mbasi të arrihet një marrëveshje ndërmjet palëve të informohet popullata rreth rezultatit. Gjykimi i përbashkët është se dialogu ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit duhet të ndodhë jo vetëm në mes të politikanëve, por ai duhet të njihet prej shoqërisë civile, prej popullatës, pasi në fund afekton jetët e të gjithë kategorive në Kosovë.

Pjesëmarrës

1. Z. Adem Gashi, IDK
2. Z. Agim Musliu, SEES
3. Z. Alain Lapon, UNDP Kossac
4. znj. Albana Merja, GLPS
5. Z. Albion Sherifi, NGO "NA"
6. Z. Amir Zeqiri, NGO "Change"
7. Z. Arben Gecaj, Lëvizja Vetëvendosje
8. znj. Arieta Dragusha, FIQ
9. Z. Astrit Istrefi, Saferworld
10. Z. Avdi Kamerolli, Ministria e Infrastrukturës
11. Z. Avni Rexha, MASHT
12. Z. Bedri Uka, NGO "Shpëtimtari"
13. Z. Behxhet Shala, KLMDNJ
14. Z. Clirim Hajdini, PK
15. znj. Dajana Berisha, FIQ
16. znj. Dee Dee Rodriguez, ICITAP
17. znj. Diellza Kryeziu, NGO "ETNIKA"
18. znj. Dragana Djukic, RTK2
19. znj. Drita Perezic, ICITAP
20. Z. Edis Prapashtica, PYC
21. Z. Enver Dugolli, MFSK
22. Z. Fatlum Kryeziu, KVRL
23. Z. Ferdinand Nikolla, Saferworld
24. Z. Ibrahim Arslan, Ombudsperson
25. Z. Ilir Selmanaj, CITS-translation
26. Z. Imer Thaci, MPB
27. Z. Ivo Gjokiq, MDNZ
28. Z. Jakup Hoti, Ministria e Infrastrukturës

29. znj. Jana Poljakova, AKTIV
30. znj. Jeta Xharra, BIRN
31. znj. Kaqusha Kamberi, RTV21
32. znj. Leutrim Novosella, FIQ
33. Z. Lulzim Fushtica, ICITAP
34. znj. Lumnije Kika, CITS
35. Z. Melvin Asin, EU
36. Z. Michael Marsden, EULEX
37. Z. Nazim Haliti, FIQ
38. znj. Reusser Denise, KFOR LMT
39. Z. Rexhep Selimi, KPSPB
40. Z. Rifat Marmullaku, OSCE
41. Z. Safet Blakaj, Labyrinth
42. Z. Sasa Viric, CITS
43. Z. Scheiwiller Thomas, KFOR LMT
44. Z. Stojan Pelko, EUCR
45. znj. Suzana Emini, NGO "Ruka+Ruci"
46. Z. Zeljko Virijevic, DSC
47. Z. Zorica Bulatovic, RKS



Projekt i financuar nga BE-ja dhe i menaxhuar nga Zyra e Bashkimit European në Kosovë